



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2011 Prot

Vlorë, më 29.09.2025

VENDIM

Nr. 17, datë 25.09.2025

PROPOZIM PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 25.09.2025 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikës 4 dhe 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” i ndryshuar, kërkesës së Z. Kristo Andrea Çipa për përfitim shtese pensioni të posaçëm shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 1847 Prot, datë 11.09.2025 si dhe shkresës së bashkisë Himarë Nr. 6853 Prot, datë 09.09.2025 me lëndë “Kërkesë për akordim pensioni për z. Kristo Çipa, “Mjeshtër i Madh”,

VENDOSI;

1. T'i propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e shtesës së Pensionit të Posaçëm Shtetëror Zotit Kristo Andrea Çipa, për kontributin dhe talentin e spikatur në lëvrimin e këngës polifonike të Bregdetit. Për arritjet si poet, prozator, publicist, organizator i grupeve folklorike, përçues i traditës dhe ideve të krijuesve popullorë e atdhetarë në trevën e Himarës.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social/ Sektori i Ligjshmërisë, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit Territorit në Këshillin e Qarkut Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ervis Mocka

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën Nr. _____ Prot, datë _____.2025.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkavlore.gov.al
E-mail: info@qarkavlore.gov
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe pikës 4 e 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” i ndryshuar, Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë ata persona që:

- Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;
- Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;
- Kanë vuajtur nga persekutimi politik nën regjimin komunist.

Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë personat të cilët përmbushin kushtet e sipërpërmendura si shtesë mbi pensionin që u takon nga Sigurimet Shoqërore, ose si pension nëse nuk përfitojnë pension nga Sigurimet Shoqërore.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur z. Kristo Andrea Çipa, i lindur më 15.11.1959 Vlorë, dhe banues në Pilur- Himarë, ka paraqitur kërkesë pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë për përfitim shtesë Pensioni të Posaçëm Shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 1786 Prot, datë 03.09.2025, kërkesë e cila është mbështetur edhe nga bashkia Himarë me shkresën e saj Nr. 6853 Prot, datë 09.09.2025 me lëndë “Kërkesë për akordim pensioni për z. Kristo Çipa, “Mjeshtër i Madh”.

Kërkesa drejtuar institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë mbështetet në punën e palodhur, kontributin dhe mundin e tij në lëvrimin e këngës polifonike të Bregdetit, si dhe në arritjet si poet, prozator, publicist, organizator i grupeve folklorike, përçues i traditës dhe ideve të krijuesve popullorë e atdhetarë në trevën e Himarës.

Zoti Çipa gjatë gjithë jetës së tij nuk është larguar nga vendi i origjinës, vend me tradita të shumta, Piluri. Në këtë zonë ai ka dhënë kontributin e tij të shumëllojshëm duke filluar në fushën e agronomisë, drejtues i Telekomit Himarë, anëtar i Këshillit Bashkiak Himarë, Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak Himarë, Inspektor i Kulturës në bashkinë Himarë, Përgjegjës i Portit të Himarës, etj.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

PUBLIKA E SHQIPËR

Me talentin e tij z. Çipa u bë pjesë e grupit të njohur të Pilurit që në vitin 1978 deri sa ai pushoi së qëni dhe prej këtij momenti filloi edhe aktivizimi i tij në aktivitetet kulturore të Iso- Polifonisë.

Z. Çipa ka krijuar dhe drejtuar grupin e Bregdetit të Himarës, në vitin 2004, i cili u paraqit menjëherë në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, grup i cili u bë i njohur duke u vlerësuar me çmime në aktivitete brenda dhe jashtë vendit.

Me këngët e krijuara, kompozura dhe drejtura nga kërkuesi, Grupi i Himarës ka regjistruar këngë të njohura, videoklipe, të vlerësuara maksimalisht për karakteristikat e tyre nga artdashësit dhe vlerësuesit e Iso- Polifonisë.

Si drejtues i Ansamblit Folklorik “Bejkë e Bardhë” ka organizuar gjashtë Festivale Folklorike “Netët e Bejkës së Bardhë” si dhe festivale të shkollave 9 - vjeçare të bashkisë Himarë.

Z. Çipa është autor i gjashtë vëllimeve me poezi dhe legjenda, dhjetra artikuj në shtypin e shkruar, krijues i mbi gjashtëdhjetë këngëve, i sukseshëm dhe i vlerësuar maksimalisht në çdo fushë.

Ndjenjat e theksuara patriotike, dashuria për traditën dhe trashëgiminë kulturore, kanë ndikuar në lartësimin e Iso- Polifonisë dhe transmetimin e thesarit të këngës pilurjote.

Bashkëlidhur kërkesës/propozimit gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Jetëshkrimi;
- Çertifikatë personale, me datë 25.08.2025;
- Çertifikatë familjare, me datë 25.08.2025;
- Fotokopje letërnjoftimi elektronik;
- Vërtetim për lloj dhe masë pensioni nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, datë 25.08.2025;
- Shkresë e bashkisë Himarë Nr. 6853 Prot, datë 09.09.2025 me lëndë “Kërkesë për akordim pensioni për z. Kristo Çipa, “Mjeshtër i Madh”;
- Kopje e noterizuar e Titullit “Naim Frashëri” dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 9694, datë 12.07.2016 me motivacion “Si një organizator i palodhur i grupeve tradicionale të bregdetit të Himarës. Krijues i suksesshëm dhe interpretues i veçantë, mbrujtur në djepin e këngës pilurjote”;
- Kopje e noterizuar e Diplomës/ Grupit Polifonik “Bregdeti i Himarës” dhënë në Festivalin Folklorik Mbarëkombëtar “RAPSHA 2009”- Malësi e Madhe.
- Kopje e noterizuar e Diplomës/ Çmimi “Petro Marko”, Vendi i Tretë, për vëllimin me rrëfenja “Ruzana”, botuar në vitin 2011 dhënë nga Bashkia Vlorë/Qendra Kulturore Vlorë/Biblioteka Publike;
- Kopje e noterizuar e Titullit “Mjeshtër i Madh” dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 11599, datë 11.08.2020 me motivacion “Për kontributin dhe talentin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

spikatur në lëvrimin e këngës polifonike të Bregdetit. Si poet, prozator, publicist, organizator i grupeve folklorike dhe krijuesi këngëve me karakter të theksuar lirik, shoqëror e atdhetar. Përçues i traditës dhe ideve të krijuesve popullorë e atdhetarë në trevën e Himarës“;

- Kopje e noterizuar e Diplomës “Mirënjohje” dhënë nga Shoqata Atdhetare Kulturore “Shqipëria” Asamblit Folklorik “Bejkë e Bardhë” Pilur;
- Kopje e noterizuar e Titullit “Naim Frashëri” dhënë nga Presidenti i Republikës Ansamblit Artistik “Bejkë e Bardhë”, Pilur, me Nr. Dekreti 10255, datë 04.05.2017 me motivacion “Për nivelin e shquar artistik, shkallën e lartë të interpretimit dhe origjinalitetin e transmetimit të thesarit të këngës e valles pilurjote. Me talentin dhe virtuozeitetin e tij, ky ansambël ka shënuar një faqe të veçantë në historinë e polifonisë shqiptare“;
- Kopje e noterizuar e Çmimit të Parë/ Grupit Polifonik “Pilur” dhënë në Festivalin Folklorik “Kënga Labe në Vlorë“;
- Kopje e noterizuar e Diplomës “Mirënjohja e Labërisë” dhënë Grupit Polifonik “Bregdeti” dhënë nga Shoqata Kulturore Atdhetare “Labëria“;
- Kopje e noterizuar e Diplomës “Personalitet i Shquar i Kulturës Mbarëkombëtare” me motivacion “Për kontributin e shquar në ndriçimin e traditave, kulturës dhe historisë së popullit shqiptar në publicistikën bashkëkohore” dhënë z. Kristo Çipa nga Shoqata Kulturore Mbarëkombëtare “Ismail Qemal Vlora“;
- Kopje e noterizuar e Diplomës “Personalitet i Shquar i Labërisë” dhënë z. Kristo Çipa nga Shoqata Kulturore Atdhetare “Labëria“;
- Kopje e noterizuar e Titullit “Personalitet i Shquar i Qarkut Vlorë” dhënë z. Kristo Çipa nga Këshilli i Qarkut Vlorë me propozim të Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve “Petro Marko”, Vlorë;
- Kopje e noterizuar e Diplomës/Çmimi “Dhimitër Varfi” dhënë grupit “Bejkë e Bardhë” Pilur, nga Ministria e Kulturës/ Qendra Kombëtare Veprimtarive Tradicionale në Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Iso-Polifonisë, Edicioni XIV;
- Kopje e noterizuar e Çertifikatës “Mirënjohje” dhënë grupit “Bejkë e Bardhë” Pilur, për pjesëmarrje në Edicionin e I-rë të Festivalit Folklorik “Bilbilat e Labërisë”, Tepelenë;
- Kopje e noterizuar e Titullit “Çmimi i parë” dhënë Grupit Polifonik të Himarës nga Shoqata Kulturore Artistike “Polifonia Shqiptare” për pjesëmarrje në Festivalin e II-të Ndërkombëtar Polifonik “BYLISFONIA 2008“;
- Kopje e noterizuar e Diplomës/Vendi i II-të, dhënë Grupit Polifonik të Himarës në Festivalin Folklorik Kombëtar të Iso- Polifonisë dhënë nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve/ Bashkia Berat;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

- Kopje e noterizuar e Diplomës/Vendi i III-të, dhënë Grupit Polifonik të Himarës në Festivalin Folklorik Kombëtar Tipologjik të Iso- Polifonisë dhënë nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve/Bashkia Vlorë;
- Kopje e noterizuar e Diplomës/Vendi i I-rë, dhënë Grupit Polifonik të Himarës në takimin kombëtar të Grupeve Polifonike të Shoqatës Kulturore – Artistike, dhënë nga Ministria e Kulturës /Bashkia Kamëz;
- Kopje e noterizuar e Titullit/Çmimi i I-rë “Lefter Çipa”, dhënë nga Bashkia Himarë/Ansambli Folklorik “Bejkë e Bardhë” në Festivalin e Dytë “Netët e Bejkës së Bardhë”;
- Kopje e Mesazhit të Falenderimit për Ansamblin Folklorik “Bejkë e Bardhë” dhënë nga Komiteti i Organizatës së Vetetranëve dhe Pasardhësve të LANÇ Vlorë, etj.

Duke u bazuar në kërkesën e z. Kristo Çipa, në zbatim të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të pikës 4 dhe 5 të VKM- së Nr. 429 datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” i ndryshuar, mendojmë se personi i propozuar plotëson kushtet për të përfituar këtë lloj pensioni.

Specialist/Jurist

Alma Myrtaj